

**EDMOND MALAJ**

**NË GJURMË TË MONUMENTEVE KISHTARE BRENDA  
SHKODRËS MESJETARE**

Shkodra mesjetare, përveçse ishte një qendër e rëndësishme politike dhe ekonomike, rezulton të ishte edhe një qendër e rëndësishme kishtare dhe këtë e dëshmon më së miri historia e saj kishtare e cila është e dokumentuar që në shek. IV, ku Shkodra del si qendër argjipeshkvnore, e duke vazhduar deri në ditë tona. Pra Shkodra ka një histori të dokumentuar kishtare prej afro 1700 vjetësh, duke filluar me argjipeshkvin Bassus, i cili përmendet si Argjipeshkëv i Shkodrës në vitin 387.<sup>1</sup> Duke vazhduar më tej me Senecion argjipeshkvin e Shkodrës pjesëmarrës në Koncilin e Efesit (431)<sup>2</sup> e duke ardhur deri në ditët e sotme.

Krahas dioqezanëve dhe urdhrit Benediktin (me kongregacionin e tij të Shën Maurit<sup>3</sup>/Mauricios<sup>4</sup>), i cili vepronte jo vetëm në qytet, por më tepër edhe në hinterland dhe që kishte manastiret<sup>5</sup> e tij jo shumë larg Shkodrës, brenda qytetit vërtetohet në Mesjetë edhe prezenca e urdhrave Françeskanë dhe Domenikanë, të cilët kishin përkatësisht edhe kishat e tyre, siç do ta shohim edhe më poshtë.

Në këtë artikull do të bëhet fjalë për kishat e dokumentuara brenda në qytetin e Shkodrës dhe për kishat anonime të këtij qyteti për të cilat gjejmë ndonjë të dhënë nëpër punime dhe dokumente të ndryshme, por pa

<sup>1</sup> *Illyrici Sacri. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis.* Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë. Prishtinë: Arbi 2004), f. 304-305.

<sup>2</sup> *Po aty*, f. 304.

<sup>3</sup> *Po aty*, f. 307.

<sup>4</sup> Në lidhje me kongregacionin e Shën Mauricit mund të përmendim që emri i këtij shenjtori është shumë i përhapur në zonat përreth Shkodrës. Këtu mund të përmendim Muriqanin në Anë të Malit (rrethi i Shkodrës), apo Muriqin në Krajë.

<sup>5</sup> Përsa u përket manastireve benediktine në afërsi, mund të përmendim manastirin e Shën Gjonit të Strilalit (Shtojit), (7-8 km në veriperëndim të Shkodrës), manastirin e Shën Bakut dhe Shën Shirqit në Shirq (6 km në jugperëndim të Shkodrës) dhe manastirin e Shën Mërisë së Zetës në Sappë (rreth 10 km në jug të Shkodrës).

mundur që t'i identifikojmë me emër. Vendndodhjen e këtyre kishave që do të trajtojmë e kemi ndarë në katër zona të Shkodrës mesjetare: 1. brenda kalasë; 2. përreth kodrës mbi të cilën është e vendosur kalaja; 3. përreth Kodrës së Pashës, e cila ndodhet përballë kështjellës, dhe poshtë së cilës gjendeshin dikur lagjet e vjetra Ajasëm, Tabakë dhe Karahasej; 4. përtej lumit Buna përballë qytetit, pra në zonën ku sot ndodhen dy urat (e vjetra dhe e reja) duke marrë drejtimin qoftë nga lindja në drejtim të Shirokës, qoftë nga Zusi deri tek ish-Fabrika e Çimentos, por gjithsesi pa u larguar shumë.

Ndërsa në pjesën e pestë dhe të fundit jepen të dhëna në lidhje me disa kisha, për të cilat kemi nxjerrë informacione nga studime dhe dokumente të ndryshme, por që prapëseprapë e kemi të pamundur të bëjmë një lokalizim të tyre qoftë edhe të përafërt.

### **Kisha të dokumentuara dhe anonime brenda kështjellës**

Si kishë të parë brenda kështjellës po përmendim këtu *Katedralen e Shën Shtjefnit* (*ecclesia cathedralis Sancti Stephani de Scutaro*), e cila qe bërë e famshme nëpërmjet disa mrekullive të ndodhura aty.<sup>6</sup> Kisha duket se është ndërtuar në fund të shek. XIII<sup>7</sup>, dhe është zgjeruar e meremetuar në shek. XIV<sup>8</sup>, me meremetime nga venecianët edhe në shek XV.<sup>9</sup> Nga meremetimet e shek. XIV mund të përmendim këtu atë të vitit 1319, ku nga Raguza Don Andrea nga Shkodra merr me vete për në Shkodër tre karpentierë (apo sharrtarë) për të rregulluar të gjithë korin e

<sup>6</sup> Konstantin Jireček, "Skutari und sein Gebiet im Mittelalter", në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 107.

<sup>7</sup> Aleksandër Mexi, *Arkitektura mesjetare në Shqipëri (shek. VII-XV)*. Tiranë: 8 Nëntori, 1983, f. 145.

<sup>8</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia* (më tej: AA1b). Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emlilianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MCMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 647.

<sup>9</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emlilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens) Vindobonae MCMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr.736.

kishës së Shën Shtjefnit.<sup>10</sup> Një riparim tjetër i bëhet kësaj kishe edhe në vitin 1403, nga kontkapiteni i Shkodrës, i cili sjell nga Raguza për mbulimin e kësaj kishe rreth 5000 tjegulla (*pro cpertura ecclesie katedrales sancti Stephani de Scutaro usquae ad qionquie millia cupporum*).<sup>11</sup> Ndër ngjarjet e ndodhura tek kjo kishë, përmendet edhe Car Dushani, në lidhje me dhurimin e të ashtuquajturës “Gropë e Mullirit (jaz) të Shën Shtjefnit” në Shkodër, të cilën ia kishte marrë ipeshkvisë katolike gjatë një konflikti që pati me latinët, *Manastirit të Kryeengjëllit të Prizrenit*.<sup>12</sup>

Sipas A. Meksit, për nga tipologjia e ndërtimit, pra “ndërtim i thjeshtë planimetrik e vëllimor i ngjashëm me kishën brenda *Manastirit të Rotecit (Tivar) të ndërtuar në shek. XIV, dhe me kishën e Shasit, me mure të rrafshëta, mbulesa me çati të naosit dhe me qemere të kryqëzuara të kthinës së altarit që ka edhe të vetmen dritare*” ka mundësi që është i influencuar nga arkitektura e urdhrave dominikanë dhe françeskanë,<sup>13</sup> pra, nga arkitektura e dy urdhrave që kanë qenë mjaft aktiv në Shkodrën mesjetare dhe më krahinat përreth.



Fig. 1. Pamje nga kisha e Shën Shtjefnit në kala.

Foto: Edmond Malaj

Në afërsi të saj duhet të ketë ekzistuar edhe shtëpia e ipeshkvit (domus episcopalis) e cila sipas Gj. Sheldisë, është e dokumentuar që në vitin 1251.<sup>14</sup> Megjithatë gjatë kohës së dy rrethimeve (1474-1478), ipeshkvi i Shkodrës, Francesku II që i përkiste Fretërve Minoritë, nuk gjendej në Shkodër, pikërisht për shkak të kërcënimit turk.<sup>15</sup> Turqit

<sup>10</sup> “1319, 2 junii Ragusii. Don Andreas de Scutaro ad laborandum “totem corium ecclesie Sancti Stephani de Scutaro” serum ducit Scutarum tres segatores “de arte sechete” AAlb I, nr. 647.

<sup>11</sup> AAlb II, nr. 736.

<sup>12</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 107.

<sup>13</sup> A. Meksi, *Akitektura mesjetare ...*, f. 145.

<sup>14</sup> Gjush Sheldija, *Kryeipeshkvia Metropolitane e Shkodrës e dioqezat sufragane (Shënime historike)*, Shkodër 1957-1958 (pa vit botimi e pa shtëpi botuese, botim i Kryeipeshkvisë Shkodër), f. 61.

<sup>15</sup> Gj. Sheldija, *Kryeipeshkvia Metropolitane e Shkodrës ...*, f. 61.

kishën e vjetër katedrale e kthyen në xhami, dhe deri në vitin 1685 brenda saj gjendej një organo e prishur (*organo disfatto*), të cilën ata e mbanin si trofe.<sup>16</sup> Pra një kishë që në mesjetë ishte e pajisur me organo, tregon për rëndësinë e saj dhe indirekt edhe për një nivel kulturor që kishte arritur Shkodra mesjetare, duke na dhënë të marrim me mend edhe zhvillimet e muzikës kishtarë që duhet të kenë ekzistuar në këtë qytet.

Kisha pasi u bë xhami, njihej si Xhamia e Mehmet Fatihut, apo edhe si Xhamia e Sulltan Mehmetit II<sup>17</sup>, sepse nga myslimanët mbahet si e ndërtuar nga Sulltan Mehmeti II, menjëherë pas pushtimit të Shkodrës<sup>18</sup>. Siç e thamë edhe më sipër, ky objekt kulti si kishë duket se ka pasur dy faza ndërtimi (njëra në shek. XIII dhe tjetra në shek. XIV), gjë që vihet re mirë sidomos në murin perëndimor,<sup>19</sup> pasi që në pamje të parë bie në sy guri i skuaduar mirë, ndërsa një fazë e tretë i përket kthimit të kishës në xhami, pas pushtimit osman.<sup>20</sup>

Aty në afërsi, në vend të shtëpisë së ipeshkvit deri në vitin 1951 ka ekzistuar një han i njohur si “Hani i Nokës”.<sup>21</sup> Mesa duket ky han ka qenë ndërtuar mbi themelet e ipeshkvisë mesjetare. Në veprën “*Institucionet Islame të Shkodrës*”, fakti që kjo xhami ka qenë Katedralja mesjetare e Shkodrës nuk përmendet fare dhe teksti që i dedikohet asaj nuk arrin të paktën as edhe një faqe.<sup>22</sup> Atë Zef Valentini në vitin 1936, për këtë kishë që ai e quan “mâ e bukra kishë e moçme në kalá” jep një përshkrim të saj dhe propozime se si duhet restauruar ajo.<sup>23</sup> Me pushtimin osman ndodhën edhe shndërrimet në xhami dhe minarja u ndërtua në këndin lindor, ndërmjet mureve lindore të naosit e narteksit dhe atij jugor të absidës, dhe në brendësi të ambientit të altarit u ndërtua nikja e mihrabit<sup>24</sup>. Për momentin kaq mund të themi në lidhje me këtë kishë.

<sup>16</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 107.

<sup>17</sup> Aleksandër Meksi, *Akitektura e xhamive të Shqipërisë (shekujt XV-XIX)*, Tiranë: Uegen 2007, f. 107.

<sup>18</sup> Smail Bala, Blendi Alushi, *Institucionet islame të Shkodrës*. Tiranë: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam 2011, f. 58.

<sup>19</sup> A. Meksi, *Arkitektura mesjetare në Shqipëri ...*, f. 143-145.

<sup>20</sup> *Po aty*, f. 143.

<sup>21</sup> Gj. Sheldija, *Kryepeshkvia Metropolitane e Shkodrës ...*, f. 61.

<sup>22</sup> S. Bala-B. Alushi, *Institucionet islame të Shkodrës...*, f. 58.

<sup>23</sup> Zef Valentini, “Monumenta qi po hupin. Mâ e bukra kishë në kalá”, në: *Leka VIII/1939, nr. 6*, f. 274-281.

<sup>24</sup> A. Meksi, *Akitektura e xhamive të Shqipërisë ...*, f. 108.

Së dyti për nga rëndësia mund të rendisim këtu ***Kishën e Shën Kollit pranë portës***. Kisha e Shënkollit pranë portës (*San Nicolo appresso la Porta*) na del e dokumentuar në disa burime. Sipas Jirečekut, “në qytetin e famshëm të Shkodrës”, pikërisht në këtë kishë nga murgu Hiob u vesh murgeshë, Helena, e veja e mbretit Stefan Urosh I; Helena vetë ishte franceze me origjinë.<sup>25</sup> Si “*Kisha e Shën Kollit afër Portës*” (*San Nicolo preso la Porta*), ajo përmendet edhe në Kadastrën e Shkodrës të vitit 1416<sup>26</sup>. Gjatë rrethimit të dytë të Shkodrës, Kisha e Shën Kollit, ngaqë ndodhej në një zonë e cila po goditej dendur nga artileria turke, u dëmtua dhe u shpërfytyrua mjaft rëndë<sup>27</sup>. Megjithatë, sipas Barletit, gjylja e parë që u hodh mbi të u kthye mbrapsht duke rënë kështu mbi ushtarët turq e duke bërë kërdi mbi ta.<sup>28</sup>

Sipër në kështjellë ndodhej edhe ***Kisha e Zojës së Papërlyeme***. Kjo kishë ishte brenda mureve të kështjellës dhe duhet të ketë qenë diku në afërsi të kishës së Shën Kollit pranë Portës. Ajo përmendet edhe nga Barleti gjatë Rrethimit të Dytë të Shkodrës, me rastin e një kuvendi që u mbledh tek ajo. Siç na njofton Barleti, në këtë kuvend që u mbledh, në kohën kur mbrojtësit panë ardhjen e sulltan Mehmetit II me një hordhi të madhe ushtarësh, “morën pjesë të gjithë italianët, shqiptarët e marinarët me qëllim që të merrnin zemër e të përgatiteshin për një rezistencë heroike”<sup>29</sup>. Predikimin për të ngritur moralin e mbrojtësve në këtë kuvend e mban një klerik shqiptar, i quajtur fra Bartolomeu i Urdhrit të Predikatorëve (Domenikanëve), të cilit Barleti i vë në gojë një fjalim mjaft të gjatë me efekte të shumta retorike.<sup>30</sup>

<sup>25</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 107.

<sup>26</sup> *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës (1416-1417)*, përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë: 1977, f. 21 (fl. 2a); shih edhe: Milan von Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im katholischen Damme”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 262.

<sup>27</sup> Marin Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, përkthyer nga origjinali latinisht nga Henrik Lacaj, Botim i dytë i shtuar, Universiteti i Tiranës, Tiranë: 1967, f. 85.

<sup>28</sup> *Po aty*.

<sup>29</sup> *Po aty*, f. 52.

<sup>30</sup> *Po aty*, f. 52-58.

Një kishë tjetër brenda kështjellës duhet të ketë qenë ***Kisha anonime në kala ose “Kapitaneria e kështjellit”***. Kjo ndërtesë është ruajtur shumë mirë edhe sot e kësaj dite, dhe është shndërruar në muze të kështjellës. Sipas Atë Marin Sirdanit OFM, ajo kishte qenë dikur një kishë paleokristiane, e plotësuar nga një korpus që pat shërbyer edhe si banesë klerikale e ipeshkvnore, por që në lidhje me këtë historiani dhe kleriku Sirdani nuk ishte shumë i sigurt.<sup>31</sup> Megjithatë ka disa elementë që të çojnë në konkluzionin që kjo ndërtesë të ketë qenë kishë:

1. Fillimisht vetë forma e saj me dritaret konike në façatën në anën e Drinit, formë katrore e me hark të lakuar, nga ana e oborrit ka tiparet e një kishe paleokristiane perëndimore;
2. Në façatën ballore brenda ndërtesës ka një dritare me mbrojtje hekuri e pa kapakë, me përmasat 30 cm lartësi e 50 cm gjatësi. Këto lloj dritarësh tek kishat paleokristiane shërbenin për të dëgjuar shërbesat fetare dhe meshët ata persona që akoma nuk ishin bërë të krishterë, sepse nuk lejoheshin të hynin në kishë.<sup>32</sup>

Pra, siç u tha më sipër gjatë kohës venedikase kjo ndërtesë u shndërrua në kapitaneri, kurse pas pushtimit osman ajo u shndërrua në divanhane të pashallëkut.<sup>33</sup>

### **Kisha të dokumentuara përreth kodrës së Kështjellës**

Zona përreth kodrës së Kalasë është areali i dytë ku ndodheshin shumë kisha të periudhës mesjetare, nga të cilat kemi mundur të gjurmojmë këto që po rendisim më poshtë: Tri kisha dedikuar Shën Mërisë dhe një kishë të Shën Vlashit, një kishë të Shën Apolinarit dhe më tej disa kisha të tjera, më tepër anonime të cilat u kthyen në xhami. Le t’i marrim me radhë. Si të parën mund të përmendim ***Kishën e Shën Mërisë përballë kështjellës***<sup>34</sup>, e cila gjendej diku përballë mureve të kalasë. Mesa duket në këtë kishë bëheshin zakonisht edhe mbledhjet e Këshillit të Fisnikërisë së Qytetit (*in pleno et generali consilio nobelium civitatis*

<sup>31</sup> Lec Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve*, Lezhë: Gjergj Fishta, 2004, f. 60.

<sup>32</sup> *Po aty*.

<sup>33</sup> *Po aty*, f. 61.

<sup>34</sup> Oliver Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392-1479)*, München: Oldenburg 2001, f. 137.

*Scutari more solit in ecclesia Sanctae Mariae congregato*)<sup>35</sup>. Një mbledhje të tillë e kemi të dokumentuar më datë 25 prill 1465, tek statutet e Shkodrës<sup>36</sup>. Në lidhje me të nuk kemi asnjë të dhënë tjetër dhe deri më sot nuk mund të lokalizojmë as vendndodhjen e saj të saktë.

Në lidhje me Shën Mërinë, përmendet në Shkodrën mesjetare edhe një kishë tjetër, e quajtur **Kisha e Shën Mërisë së Shkodrës**. Në regjistrin e Kadastrës kjo kishë vendoset pranë hendekut të barbakanit të kështjellës, murit të qytetit dhe afër ishte edhe sheshi i kështjellës<sup>37</sup>. Pra, kjo kishë duhet të kërkohet brenda mureve të kështjellës, dhe mbase mund të jetë edhe ndonjëra nga kishat që u përmendën më sipër. Në vitin 1371, një qytetar raguzin që ishte negociator në Shkodër, i quajtur Nikola i biri i Mati Babalit (*Nicola filii Mathe de Babalio*) i dhuron me testament kësaj kishe një shumë prej 7 dukatësh (... *et sancte Marie de Scutaro volo quod dentur ducati VII...*)<sup>38</sup>.

Më tej po përmendim këtu edhe **Kishën e Zojës Nunciatë (më vonë e Zojës së Këshillit të Mirë)**. Në lidhje me Kishën e Zojës Nunciatë (më vonë Zojës së Këshillit të Mirë), duket se ajo është e ndërtuar mbi rrënojat e ndonjë bazilike të lashtë të stilit romak, dhe ky supozim bazohet në zbulimin e një mozaiku romak që bëri arkitekti italian, U. Piazza në vitin 1929.<sup>39</sup> Sipas Gj. Sheldisë, rindërtimi i kësaj kishe u bë gjatë viteve 1920-1923, po në atë vend, mbi rrënojat e një faltoreje me rëndësi<sup>40</sup>.

Kjo kishë e mori emrin e Zojës së Këshillit të Mirë për shkak të figurës së Zojës së Këshillit të Mirë që ndodhej brenda saj. Kjo figurë e vjetër mesjetare ndodhet sot në bazilikën Santuario Madre del Buon Consiglio<sup>41</sup>, të quajtur kështu pikërisht për shkak të kësaj ikone (fugure).

<sup>35</sup> *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesat deri më 1469*/Statuti di Skutari della prima meta del secolo XIV con le addizioni fino al 1469, përgatitur nga Lucia Nadin, përkthimi i tekstit të Statuteve Pëllumb Xhufi, redaktor Ferdinand Leka, Tiranë: Onufri 2010, f. 287.

<sup>36</sup> *Po aty*, f. 382.

<sup>37</sup> *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve (1416-1417) ...*, f. 23 (fl. 3a).

<sup>38</sup> AAlb II, nr. 285.

<sup>39</sup> Ermano Armao, *Vende, Kisha lumenj, male e toponime të ndryshme të një harte të lashtë të Shqipërisë veriore*. Tiranë: Korbi 2006, f. 130.

<sup>40</sup> *AIH*, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija (arsimtar), Shkodër: 1958, fl. 11.

<sup>41</sup> Faqja e internetit të kësaj kishe në Itali është: Santuario Madre del Buon Consiglio, Gennazzano Roma, URL: <http://www.genazzanobuonconsiglio.it/> (27. 4. 2016).

Transportimi i kësaj ikone (fugureje) është i veshur me një legjendë mrekullie, të cilën ia vlen të tregohet edhe më poshtë: Kjo ndodhi ngjau afro njëmbëdhjetë vite para rrethimit dhe pushtimit të qytetit të Shkodrës nga Turqit. Sipas Gjush Sheldijës “më 25 prill 1467, ndjekë prej dy shkodranëve, Gjergji e De Sclavis, fugarja e Zojës së Këshillit të Mirë që ndodhej në Kishën e Nunciatës bri kalaje, iku këtej dhe vojt e xuni vend mbi muret e Kishës së Shën Vlashit, në Gjenacan, që kishte nisë me rindërtue plaka Pjetrushë, në orën katër mbasdreke, në praninë e një shumice të madhe të popullit që kishte rrâ aty për festë.”<sup>42</sup>

Në 15-vjeçarën e parë të shek. XX disa persona nga popullsia myslimane e Shkodrës pretendonin se rrënojat e kësaj kishë të lashtë ishin të një manastiri bektashian,<sup>43</sup> gjë që e përmend edhe Gjush Sheldija në relacionin e tij, ku thotë se “rreth vitit 1800 pat qenë përkohësisht “teqe bektashinjsh”, por manej e lëshuen”<sup>44</sup>, porse, sipas dom Nik Ukgjinit kjo kishë pas pushtimit osman u kthye në xhami me emrin “xhamia e Sulltan Mehmetit II”.<sup>45</sup> Ekzistencën e teqes e përmend edhe H. Bushati, kur thotë që “Kishën e Zojës” në lagjen Alibegaj e kishin kthye në teqe dervishësh, pa përcaktuar përkatësinë e tyre në ndonjë tarikat.<sup>46</sup> Kurse Xhamia e Sulltan Mehmetit II, siç e thamë edhe më sipër qe kisha e shndërruar e Shën Shtjefnit Protomartir.

**Kisha e Shën Vlashit.** Në lagjen që ndodhej para qytetit, të ashtuquajtur “Nënshkodër” (*Sub-Scutari*), tek një kishë aty, që ishte “Kisha e Shën Vlashit (Blasius)” banonin tregtarë raguzanë (*extra Scutari ad Sanctum Blasium 1433, S. Blasius prope civitatem Scutari 1444*).<sup>47</sup> Kisha përmendet edhe nga Barleti. Gjatë rrethimit të dytë, në muajin korrik osmanët vendosën sipër saj një top të tipit mortajë, që mund të gjuante përpjetë një gjyle me peshë prej njëmijë e dyqind librash.<sup>48</sup> Çuditërisht Shuflaj na njofton se në vitin 1452 kjo kishë u shemb nga kapiteni

<sup>42</sup> Gj. Sheldija, *Kryepeshkvia Metropolitane e Shkodrës ...*, f. 13.

<sup>43</sup> Irhan Jubica, “Kisha e Zojës së Këshillit të mirë”, në gazetën *Fjala e Shkodrës*, nr. 6, 1999.

<sup>44</sup> *AIH*, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 11.

<sup>45</sup> Nikë Ukgjini, “Arbëria-Sqiperia si hapësirë e krishterimit”, në gazetën *Shqiptarja.com*, datë 14. 9. 2014.

<sup>46</sup> Hamdi Bushati, *Shkodra dhe motet. Traditë, ngjarje, njerëz*, vëll. I, Shkodër: Rozafat, 1998, f. 618.

<sup>47</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 108.

<sup>48</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës ...*, f. 60.

venecian i Shkodrës, kur po përgatitej kundër rrethimit të bërë nga despoti serb.<sup>49</sup> Ai rrënoi këtë kishë bashkë me manastirin, meqë ajo ndodhej shumë afër mureve të qytetit, dhe materiali që dilte nga rrënimi i saj do t'i shërbente atij për fortifikimin e qytetit.<sup>50</sup> Më 4 shtator 1452, murgjit “e Kuvendit të Shën Vlashit jashtë mureve të Shkodrës”



Fig. 2. Kisha e Shën Vlashit në Shkodër.

Foto nga Th. Ippen

(*monachi conventus s. Blasii extra muros Scutari*) u ankuan për këtë punë në Venedik, dhe atyre iu premtua dëmshpërblim i plotë.<sup>51</sup> Murgjit pretendonin, se manastiri nuk ishte ndërtuar në kohën e sundimit të mbretit Dushan (*sub Stephane rege Rascie*), gjë që Shuflaj mendon se ka ndodhur vetëm për kishën, e cila sigurisht ishte themeluar nga raguzanët, mesa duket gjatë viteve të murtajës.<sup>52</sup> Kjo kishë duhet të jetë rinovuar sërish menjëherë, përdërisa pas pushtimit osman ishte përsëri në këmbë.

Sipas Ippenit dhe Shllakut kjo kishë në kohën e Perandorisë Osmane për shkak të afërsisë së madhe me kalanë, ngaqë ndodhet poshtë saj, u kthye në banjë turke, e ashtuquajtura “*Hamami*” apo “*Banja e madhe*” për trupat e garnizonit osman<sup>53</sup>. Ky shndërrim duket se ka ndodhur në shekullin e errët XVI, pikërisht në vitin 1518.<sup>54</sup>

Kisha, si arkitekturë në origjinën e saj kishte qenë e stilit romak gjë që e dëshmonin tullat romake që gjendeshin në muret e saj, por më vonë

<sup>49</sup> M. Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen ...”, f. 262.

<sup>50</sup> Po aty.

<sup>51</sup> “Senato Mar. 4 fol. 144 v. Kronisti Manjo (Magno) (Jorga, Notes 3, 227 N. 1) përmend, që më 19 shtator 1448, gjatë një rënie zjarri të papritur por të tmerrshme në qytet (*krahaso Ljubić 9, nr. 285*) u futën natën për të gjetur mbrojtje një turmë njerëzish në një kishë të vogël “që është sipër murit” (*che e sopra il muro*) dhe aty gjetën vdekjen 500 persona”. Po aty.

<sup>52</sup> Po aty.

<sup>53</sup> Theodor A. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische Küstenebene*, Von Theodor A. Ippen K. u. K. Österr-Ungar. Generalkonsul. Mit 24 Abbildungen. Sarajewo: Daniel A. Kojan 1907, f. 23; L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve ...*, f. 42.

<sup>54</sup> *AIH*, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 7.

u futën aty edhe elementë bizantinë dhe në fund edhe elementë osmanë. Si element bizantin, mund të përmendet këtu forma e saj e kryqët që e ruajti deri sa u shkatërrua.<sup>55</sup>

Absidi i saj ishte në drejtim të verilindjes, por u dëmtua rëndë në periudhat e fundit, kur bashkia e atëhershme e Shkodrës hapi aty një derë.<sup>56</sup> Më vonë, kur konsulli Ippen ndodhej në Shkodër, ajo qe shndërruar në magazinë vajguri.<sup>57</sup> Në kishën e Shna Vlashit duket se gjendeshin kapituajt e urdhrit dominikan.<sup>58</sup>

Ndërtesën e kësaj kisha që në formën e hamamit e arriti deri pas gjysmës së dytë të shek. XX, na e përshkruan Lec Shllaku si në vazhdim: *“Nji ndërtesë e rallë e hijerëndë, e veshun me gurë të gllendun, nga shën Vlashi i vjetër kishte ngelë forma e saj e vjetër e nji tempulli bizantin në trajtë kryqi, me harqe, ... gjatësia e ndërtesës kapte 25 hapa kurse ajo e dy krahëve diçka ma pakë se dyzet hapa, naltësia e kupolës qendrore përbrenda mbërrinte në 8. 50 metra kurse ato dy ansoret, nuk i kapnin shtatë metrat. Ndërsa kishte mure të trasha prej guri, që në krahët e derës kapnin prej 0.90 m deri në nji metër.”*<sup>59</sup>

Edhe studiuesi dhe arsimtari Gjush Sheldija e dëshmon këtë objekt si në gjendje të mirë, të paktën deri në vitin 1958.<sup>60</sup> Shllaku ka konstatuar në afërsi të saj edhe rrënoja gurësh masiv të gdhendur, dhe këto rrënoja ishin në një vijë të drejtë me gjatësi 12 deri 13 metra, të cilat po sipas L. Shllakut mund të kenë qenë *“kolona me harqe, për të mbajtë përsipër nji terracë, që shërbente edhe si vend zgjatimi për oborrin rrethues, fort të ngushtë, që kishte kisha e njëkohësisht aty ku takoheshin me ujin, si pendë për të pritë vërshimet e mundshme të lumit në kohë përmbytjesh”*.<sup>61</sup> Mbase këto rrënoja të dëshmuara nga Shllaku, që sot për fat të keq nuk janë më, i përkisnin kapitullit të Urdhrit Domenikan.<sup>62</sup>

<sup>55</sup> Po aty.

<sup>56</sup> Po aty.

<sup>57</sup> Theodor Ippen, *Shqipëria e Vjetër. Studime gjeografike, etnografike, historike nga ish-konsulli i përgjithshëm i monarkisë austro-hungareze në Shkodër*, Përkthyer nga origjinali: Gjerak Karaiskaj, Ardian Klosi. Me riprodhimin e fotografimeve dhe skicave origjinale të Ippenit, Tiranë: K&B 2002, f. 107.

<sup>58</sup> Giuseppe Valentini, *Kontribute në kronologjinë e historisë së Shqipërisë (1060-1560)*, Tiranë: Plejad 2010, f. 167.

<sup>59</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve ...*, f. 46.

<sup>60</sup> *AH*, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 7.

<sup>61</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve ...*, f. 46.

<sup>62</sup> G. Valentini, *Kontribute 1060-1560 ...*, f. 167.

Duhet të përmendet këtu që qoftë niveli i Bunës, qoftë ai i liqenit të Shkodrës në kohrat mesjetare ka qenë më i ulët pasi Drini, që më vonë (shek. XIX) çoi në rritjet e nivelit të ujit, ka kaluar nga Lezha. Pra, për kishën e Shën Vlashit Buna nuk mund të ketë qenë e rrezikshme. Në lidhje me rrjedhën e Drinit jashtë Shkodrës, na jep dëshmi edhe Barleti kur thotë që Drini në kohën e tij rridhte 8 milje larg qytetit.<sup>63</sup> Po sipas përshkrimit të Shllakut, kupola sipër ishte edhe me dritare që lejonte depërtimin e dritës e cila krijonte një ndriçim magjepsës, dhe “*dukej sikur qiella vetë, ajo kupë kaltërsie të pakufi kishte zbritë deri poshtë, për ti përfshi e për ti mbushë me dritë ato kupa të kufizume, që xixëllonin si hyj shumë ngjyrësh në zgavrat e tavanëve të savotuem pastër e lyem me gëlqere të bardhë, vezulluese. Prej mënyrës së punimit e përmasave të bollshme që kishte si tavani, si zgavrat e kupoleve, nuk kishte asnjë dyshim se në kohën, kur ajo kishte qenë objekt kulti, në to do të kishte pasë afreske murore.*”<sup>64</sup>

Oborri i kësaj kishe lidhej me kalanë e Shkodrës nëpërmjet një tuneli që ngjitej përpjetë me anë të shkallëve elikoidale (rrethore), të cilat të çonin brenda oborrit të kështjellës, disa metra pas Katedrales së Shën Shtjefnit.<sup>65</sup> Hyrja e këtij kalimi të fshehtë mund të shihet edhe sot e kësaj dite. Ky tunel mesa duket që shkatërruar pjesërisht nga Luftërat Ballkanike dhe më vonë edhe nga punimet xheniere të austro-hungarezëve për ndërtimin e hyrjes së re të Shkodrës, poshtë kalasë.<sup>66</sup>

Gjatë kohës së regjimit komunist ky objekt i rëndësishëm historik që përdorë si magazinë, e pastaj që shkatërruar gjatë “revolucionit kulturor” i cili shkatërroi shumë objekte kulturore në Shkodër dhe në të gjithë Shqipërinë. Mbi rrënojat e kësaj kishe-hamam u ndërtua pas vitit 1995 edhe restorant, i cili varrosi me beton njëherë e mirë edhe ato çfarë kishin mbetur nga objekti. Kështu humbi një herë e mirë një ndër monumentet

<sup>63</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës...*, f. 37.

<sup>64</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve ...*, f. 47. U ndala në këtë përshkrim të Lec Shllakut, pasi është i vetmi përshkrim i këtij monumenti kishtar, që kam gjetur deri më tani, nga një prej dëshmitarëve të fundit okularë dhe ndoshta të vetmit, të cilët e kishin vizituar këtë objekt enkas për ta studiuar.

<sup>65</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve ...*, f. 57; Willi Kamsi, “Kisha e kuvende të Shkodrës me rrethina në Mesjetë”, në *Krishterimi ndër shqiptarë*, Simpozium ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, Shkodër: Konferenca Ipushkvnore e Shqipërisë, 2000, f. 122.

<sup>66</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve ...*, f. 58.

më të rëndësishme<sup>67</sup> jo vetëm të Shkodrës por të mbarë Shqipërisë së periudhës mesjetare. Në literaturën myslimane ky objekt përmendet si Hamami i Xhamisë së Skelës (së peshkut), i ndërtuar nga një person i quajtur Kara Hyseni para vitit 1662<sup>68</sup>, dhe nuk përmendet aspak origjina e saj si kisha e Shën Vlashit.

**Kisha e Shën Aponales.** “Kisha e *San Aponale*”<sup>69</sup> apo e *Shën Apolarit*<sup>70</sup> gjendej tek këmbët e Malit të Shkodrës (mali mbi të cilin gjendet kështjella *Rozafat*). Kjo kishë mesa duket ndodhej në pjesën ku kishte qenë dikur qyteti i vjetër i Shkodrës, pra tek muret rrethuese<sup>71</sup> në afërsi të Kishës së të gjithë Shenjtorëve.<sup>72</sup> Sot nga gjurmët e saj nuk mund të gjendet asgjë dhe nuk mund ta lokalizojmë me saktësi, se ku duhet të jetë ndodhur.

**Kisha anonime tek Xhamia e Selvisë (Masllupit).** Gjurmët arkeologjike të çojnë tek një kishë e cila ka ekzistuar para pushtimit osman. Sipas Gjush Sheldisë bri saj duken gjurmët e një ndërtese të moçme që ka strukturën e një baptisteri apo të një absidi, dhe kjo ndërtesë “ka mujtë me qenë Katedralja e Shkodrës, të cilën e përmend më 22. I. 1346, Klementi i VI.”<sup>73</sup> Sipas autorëve Smajl Bala dhe B. Alushi, xhamia në vend të saj, e cila njihej edhe me emrin “Xhamia e Hynqarit” që ndërtuar nga Sulltan Bajaziti në vitin 1478 rrëzë kalasë “Rozafat” dhe përbri “Urës së Vøeve”,<sup>74</sup> (sipas W. Kamsit në krah të majtë para se me mbërrit tek kjo urë<sup>75</sup>), pra pak para pushtimit osman, në kohën kur Shkodra që e rrethuar nga ushtritë turke. Këtu ka një problem, sepse ndërtimi i saj lidhet me Sulltan Bajazitin II, ndërkohë që në këtë kohë sulltan ishte në pushtet dhe i pranishëm në rrethimin e qytetit Mehmeti II (i mbiquajhuri Fatih),<sup>76</sup> pra një pararendës i Bajazitit II.<sup>77</sup>

<sup>67</sup> *AIH*, G-I-24, Monumentat historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 7.

<sup>68</sup> S. Bala-B. Alushi, *Institucionet islame të Shkodrës* ..., f. 65-66.

<sup>69</sup> *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve (1416-1417)* ..., f. 24.

<sup>70</sup> *Po aty*, f. 131 (fl. 129 b).

<sup>71</sup> M. Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen ...”, f. 262.

<sup>72</sup> *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve (1416-1417)* ..., f. 24 (fl. 5a).

<sup>73</sup> *AIH*, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 9.

<sup>74</sup> S. Bala-B. Alushi, *Institucionet islame të Shkodrës* ..., f. 68.

<sup>75</sup> W. Kamsi, “Kisha e kuvende të Shkodrës...”, f. 125.

<sup>76</sup> Aty gjithashtu nuk përmendet as se ishte e ndërtuar përbri kishës ose mbase pjesërisht sipër saj. S. Bala & B. Alushi, *Institucionet islame të Shkodrës* ..., f. 68.

<sup>77</sup> Referimi tek Sulltan Bajaziti II është për shkak të një mbishkrimi që ka ekzistuar mbi portën e xhamisë, ku thuhet: “*I zoti i bamirësinave dhe i zburimeve Sulltan Bajazit*”

Sulltan Bajaziti II, në fakt pati qenë në Shqipëri në vitin 1492 dhe qëndroi në aty për shumë kohë, gjatë së cilës ai shkretoi zonat përreth Tepelenës duke u munduar të nënshtronte edhe himarjotët.<sup>78</sup> Pikërisht gjatë kësaj kohe mund të jenë ndërtuar shumë xhami nëpër qytete si Shkodër, Elbasan, Berat, Përmet Skrapar, Delvinë, Tepelenë dhe Gjirokastër.<sup>79</sup> Pra, ndërtimin e xhamisë së lartpërmendur të Selvisë duhet ta vendosim pikërisht në vitet 90 të shek. XV<sup>80</sup>, pra e ndërtuar mbi rrënojat e kishës, e cila shtrihej e shkatërruar tashmë që në kohën e pushtimit të Shkodrës, sepse në ndërtesën e saj viheshin re tri faza ndërtimi, nga të cilat dy të parat i përkisnin periudhës mesjetare.<sup>81</sup>

Afër saj, diku në krah të majtë para “Urës së Vëve”, W. Kamsi na informon edhe mbi ekzistencën e një kisha tjetër të mbetur në kujtesën e popullit si “Zoja e Pazarit”<sup>82</sup> Në fakt me këtë emër njihej një shesh i vogël i ndodhur pranë një xhamie dhe një tyrbeje. Pikërisht në këtë shesh studiuesi Kamsi mendon se duhet të ketë ekzistuar në mesjetë ndonjë kishëz apo elter i vogël e cila pas shkatërrimit të saj u kthye në toponim e u ruajt në kujtesën e popullit në mënyrë të vetvetishme.<sup>83</sup> Sot për fat të keq topografia e atij vendi është e ndryshuar krejtësisht dhe nuk gjejmë as xhaminë as sheshin, mbi të cilin mendohej kisha, as xhaminë e vjetër e as tyrben e dikurshme.

**Kisha “Konaku i Zojës” në themelet e Tyrbes së Kasem Ali Sulltanit.** Kjo kishë e vogël dedikuar Zojës së Bekueme, duhet të ketë qenë “Kisha e Shën Marisë pranë Kështjellës”, të cilën më vonë turqit e bënë xhami, dhe i dhanë emrin “Kasem Ali Sulltani”<sup>84</sup>. Studiuesi Gjush Sheldija e cilëson këtë objekt jo si xhami por si Tyrbja e Kasem Alli

*Hani, viti 883 (1478 –H.B.). i zoti i riparimit për shpirtin e Haxhi Jusuf Cekës, viti 1271 (1854)”, pra sigurisht e vendosur gabimisht si datë nga riparuesi i saj. Shih: H. Bushati, Shkodra dhe motet ..., f. 250.*

<sup>78</sup> Aleksandër Meksi, “Rreth Arkitekturës së xhamive të shekujve XV-XVI në Shqipëri”, në *Monumente 1987*, nr. 1, f. 166.

<sup>79</sup> Po aty, f. 167.

<sup>80</sup> Po aty.

<sup>81</sup> W. Kamsi, “Kisha e kuvende të Shkodrës ...”, f. 125.

<sup>82</sup> Po aty.

<sup>83</sup> Po aty.

<sup>84</sup> *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV, I (1400-1405)*, përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, Redaktor përgjegjës Aleks Buda. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë 1987, nr. 327, f. 394.

Sulltanit, e cila ndodhej nën urën e vjetër të Drinit duke dalë nga Shkodra.<sup>85</sup>

Sipas Gjush Sheldisë, të dhënat e para mbi këtë monument kishtar i gjejmë tek një relacion i vitit 1700 të Bonannos, ku thuhet se kjo tyrbe ishte e ndërtuar në stilin romanesk dhe kishte qenë një kishë e vjetër e ndërtuar mbi trojet e një faltoreje romake.<sup>86</sup> Për këtë kishë, më vonë gjejmë të dhëna edhe tek veprat e Theodor Ippen-it dhe të Atë Fulvio Cordignano-s. Ippeni në lidhje me këtë kishë, në veprën e tij me titull *“Skutari und die nordalbanische Küstenebene”* (Shkodra dhe rrafshina bregdetare veriore shqiptare) shkruan se *“Xhamia e Kasem Ali Sulltanit me minare të rrëzuar e ndodhun në breg të Drinit (Drinasës), përmballë “Zojës së Papërlyeme” mbahet si dëshmia më e vjetër e mohamedanizimit (islamizimit) të qytetit. Këtu duhet të jetë shpallë për herë të parë besimi i ri. Ajo mban emrin e një dervishi, i cili sipas traditës e entuziazmonte ushtrinë që kishte rrethuar kështjellën me predikime të zjarrra dhe që pastaj e shndërroi edhe kapelën në xhami. Tyrben e tij e ndan nga shtëpia e Zotit një rrugë. Historia politike e shekujve të parë të sundimit turk nuk la asnjë kujtim në lidhje me të”*<sup>87</sup>.

Kurse Cordignano, 37 vite më vonë, në veprën e tij me titull *“Catasto veneto di Scutari e Registrum Concessionum”* (Kadastra venedike e Shkodrës dhe Regjistri i konçesioneve), në lidhje me këtë kishë na jep këtë përshkrim: *“Posa kalohet ura e Drinit tue ardhë prej Bahçalleku, ndeshet tash në të majtë në breg të lumit një xhamí e vogël e braktisun e pa çati, me pjesën e poshtme të minares të përmbysun, dhe populli pohon se ajo xhamí paska qenë para pushtimit turk «Konaku i Zojës»”*<sup>88</sup>

Tani në lidhje me tyrben dhe gjurmët kishtarë brenda saj, Gjush Sheldija, drejtor i komisionit të Muzeut të Shkodrës në vitin 1950 raporton që kjo tyrbe kishte pasur të ngulur në mur një rrasë të Septim Severit, e cila u shkul dhe u mor nga austriakët në vitin 1917, dhe krahas kësaj pllake, gjatë punës së komisionit ishte gjetur afër saj edhe një

<sup>85</sup> AIH, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 7.

<sup>86</sup> Po aty.

<sup>87</sup> Th. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische ...*, f. 24-25.

<sup>88</sup> Fulvio Cordignano, *Catasto Veneto di Scutari e Registrum Concessionum*, Vol. I *Catasto Veneto di Scutari*. 2a. ediz. Tolmezzo 1944, f. 176. Përkthimi i mësipërm është marrë nga W. Kamsi, “Kisha e kuvende të Shkodrës ..., f. 122.

ujëbekore dhe brenda saj kishte pasur edhe afreske të cilat kishin ardhur duke u zhdukur me kalimin e kohës.<sup>89</sup>

Edhe *Xhamia e Plumbit* në Shkodër, që sipas A. Meksit i përket periudhës klasike osmane<sup>90</sup>, e ngritur në vitin 1773-1774 (1187 H) nga Mehmet Pashë Plaku<sup>91</sup>, është ndërtuar mbi një kishë të vjetër mesjetare dhe kjo kuptohet qysh tek muret<sup>92</sup> e saj që janë më të vjetra se koha e Mehmet Pashë Plakut të Bushatllinjve, i cili, pra mbahet si ndërtuesi i saj, dhe sipas disa autorëve e kishte përfunduar së ndërtuari këtë në vitin 1762 (sipas një rrese të shkruar në osmanisht, të cilën e mbante në shtëpinë e tij kleriku Esat Myftia).<sup>93</sup> Bile gjurmë kishe përbën edhe kupola e saj qendrore e cila thuhet se ka pasur afreske.<sup>94</sup>

Një gjurmë tjetër kishe brenda kësaj xhamie është edhe vendi ku qe ndërtuar minarja, e cila mesa duket ishte lartësuar mbi sakristi, ashtu siç ishte vepruar edhe me kishën në kala.<sup>95</sup> Në lidhje me ndërtimin e Xhamisë së Plumbit mbi këtë kishë anonime, duke përdorur madje edhe pjesë nga muret e saj, në literaturën myslimane shqiptare hëpërhë nuk kemi mundur të gjejmë të dhëna.<sup>96</sup> Se, cila mund të ketë qenë kjo kishë, këtë akoma nuk jemi në gjendje ta mësojmë, për shkak të mungesës së dokumenteve. Në lidhje me ndërtimin e xhamisë në truallin e kishës, sipas Codignano-s, “kjo nuk na çuditë sepse dihet zakoni që kishin turqit për me shndërrue në xhamia vendet kushtue kultit të krishterë.”<sup>97</sup>

**Kisha e Gjithë Shenjtorëve.** “Kisha e Gjithë Shejtorëve” (*Ogni Sancti*, serb. *Sveti Vrač*, e quajtur ndryshe edhe Mjekët e shenjtë, që bëhet fjalë për Kozmain dhe Damianin, diku poshtë Malit të Shkodrës<sup>98</sup>). Edhe kjo duhet të kërkohet diku në pjesën ku kishte qenë dikur qyteti i

<sup>89</sup> AIH, G-I-24, Monumentat historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 8.

<sup>90</sup> A. Meksi, *Akitektura mesjetare...*, f. 82.

<sup>91</sup> S. Bala & B. Alushi, *Institucionet islame të Shkodrës ...*, f. 40; Krahaso edhe: A. Meksi, *Arkitektura mesjetare ...*, f. 83.

<sup>92</sup> AIH, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 8.

<sup>93</sup> Po aty.

<sup>94</sup> Po aty.

<sup>95</sup> Po aty.

<sup>96</sup> S. Bala & B. Alushi, *Institucionet islame të Shkodrës ...*, f. 40-43.

<sup>97</sup> F. Codignano, *Catasto Veneto ...*, f. 176. Cituar sipas: W. Kamsi, “Kisha e kuvende të Shkodrës ...”, f. 122.

<sup>98</sup> *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve (1416-1417) ...*, f. 24 (fl. 32 b).

vjetër i Shkodrës, pra tek muret rrethuese,<sup>99</sup> sipas kadastrës diku poshtë tek këmbët e *Malit të Shkodrës, në anë të Shkodrës*.<sup>100</sup>

*Manastiri Benediktin ose “Shtëpia e vezirëve(?)”*. Ky manastir përmendet nga Gjush Sheldija në relacionin e tij të vitit 1958. Ai duhet të kërkohet në lagjen e dikurshme Alibegaj të Shkodrës, duke marrë rrugën e vjetër për tek lagja e Tabakëve, nëpërmes urës së Drinit, e cila nuk është më e përdorshme, ose para urës, nën muret e kështjellës<sup>101</sup>.

Sipas Sheldijës, mbi mbeturinat e këtij manastiri që vendosur më vonë shtëpia e Bushatllinjve,<sup>102</sup> por këto të dhëna bien ndesh me të dhënat që jep Lec Shllaku, i cili thotë që ky manastir ndodhej poshtë kalasë dhe lidhej me të nëpërmjet njëres degë të tunelit të nëndheshëm që zbriste me shkallë elokoidale nga oborri i kalasë.<sup>103</sup> Dega tjetër e lidhte kalanë me Kishën e Shën Vlashit.<sup>104</sup> Hyrja e këtij tuneli ekziston edhe sot e kësaj dite dhe deri në një farë thellësie mund të zbritet me shkallë, por pastaj të dy krahët e tuneleve janë të shembura.

Rrënojat e këtij manastiri, siç tregon L. Shllaku, shiheshin pjesërisht në këmbë deri nga viti 1936, të cilat përdoreshin si një vendstrehim karburantesh, por nga një shembje e madhe e mureve rrethuese që braktisur përfundimisht deri sa nuk mbeti shenjë prej tyre. Rizbulimi i tyre u bë nga gërmimet arkeologjike në vitet 80.<sup>105</sup> Më vonë gjatë viteve 1992-2000, kjo zonë arkeologjike, e lënë në mëshirë të fatit, pambrojtur nga shteti, u zu nga persona të ndryshëm dhe aty u bënë lloj-lloj ndërtimeve duke fshirë njëherë e përgjithmonë gjurmët e këtyre monumenteve mesjetare.

Në Shkodër ka ekzistuar edhe Lagja e *Shën Jakut*<sup>106</sup>, emri i së cilës ka të ngjarë që ka lidhje me ndonjë kishë dedikuar këtij shenjt. Kjo lagje ishte diku poshtë mureve të kështjellës, në afërsi të rrugës publike.<sup>107</sup> Nuk përjashtohet mundësia që ndonjëra nga kishat anonime të sipërpërmendura, të ketë pasur lidhje me lagjen dhe me këtë shenjt.

<sup>99</sup> M. Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen ...”, f. 262.

<sup>100</sup> *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve (1416-1417) ...*, f. 24 (fl. 5a).

<sup>101</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve ...*, f. 57.

<sup>102</sup> *AIH, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ...*, fl. 10.

<sup>103</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve ...*, f. 57.

<sup>104</sup> *Po aty*.

<sup>105</sup> *Po aty*.

<sup>106</sup> *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve (1416-1417) ...*, f. 23 (fl. 3b).

<sup>107</sup> *Po aty*.

### **Kisha përreth Kodrës së Pashës (Lagjet Ajasëm, Tabakë dhe Karahasej)**

Në Shkodrën mesjetare ekzistonte edhe “*Kisha e Shën Lazarit*”. Ajo përmendet nga Barleti<sup>108</sup> dhe më vonë edhe nga Ippeni. Gjendej diku në zonën midis lagjes së Tabakëve dhe lagjes Karahasej, apo mbi kodrën e ashtuquajtur “Mali i Pashës” (Mons Bassae), e cila ndodhet afër kodrës së kalasë. Ky emërtim përveçse tek Barleti hasej edhe në dokumente të periudhës osmane.<sup>109</sup> Sipas Barletit, gjatë rrethimit të Shkodrës poshtë saj, në korrik 1478 u vendos një top shumë i madh që hidhte një predhë prej njëmijë e dyqind librash, dhe që u quajt “artileria e Sulltanit”, ngaqë e kishin ndërtuar në emër të tij.<sup>110</sup> Merret me mend që kjo kishë duhet të jetë shkatërruar pikërisht gjatë kësaj kohe.

Kisha e Sh. Prendës (*S. Veneranda*) apo “*Kisha e Shna Premtes*” siç mund të quhet ndryshe në gjuhën popullore, gjendej po ashtu, diku në zonën midis lagjes së Tabakëve dhe lagjes Karahasej, apo mbi “Kodrën e Pashës”<sup>111</sup>. Në kadastrën e Shkodrës kjo kishë lokalizohet në mal (me siguri në Kodrën e Bashës), “*ku qëmoti ishin Kazenet përballë portës kryesore të qytetit të Shkodrës*”<sup>112</sup>. Gjatë Rrethimit të Dytë të Shkodrës, në verën e vitit 1478, afër kësaj kishe u vendosën trupat e Daut Ganjollës, Pashës së Përgjithshëm të Rumelisë dhe disa kohë më vonë u vendos mbi të edhe një top i madh, sipas Barletit, topi i katërt, i cili gjuante gurë që kishin një peshë prej gjashtëqind e pesëdhjetë librash.<sup>113</sup> Kjo periudhë duhet të ketë qenë edhe fundi i kësaj kishe.

***Kisha e Shën Kryqit.*** Në qytetin mesjetar ka pasur edhe një kishë të Shën Kryqit (Santa Croce)<sup>114</sup>. Kjo kishë përmendet edhe në regjistrin e kadastrës së Shkodrës (1416-17). Për të thuhet, se në atë kohë ishte

<sup>108</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës ...*, f. 58.

<sup>109</sup> Th. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische ...*, f. 24.

<sup>110</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës...*, f. 59.

<sup>111</sup> “Kodra e Pashës” (Mons Bassae) quhet kështu, sepse gjatë Rrethimit të Dytë të Shkodrës nguli shatorren e vet mbi të, Daut Ganjolla, Pasha i Përgjithshëm i Rumelisë, i cili ishte me origjinë shqiptare (nga Epiri) dhe të krishterë, por që ishte marrë nga osmanët që në moshë të vogël. Shih për më tepër: *Po aty*, f. 42, 51; shih dhe Th. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische ...*, f. 24.

<sup>112</sup> *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve (1416-1417) ...*, f. 26 (fl. 6ab).

<sup>113</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës...*, f. 51.

<sup>114</sup> K. Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen ...”, f. 107.

kthyer tashmë në rrënojë,<sup>115</sup> e cila mbase duhet të kërkohet, sipas Ippenit, diku në breg të Kirit, në zonën midis lagjeve të vjetra të Tabakëve dhe të Ajasmës,<sup>116</sup> pra jashtë mureve të Shkodrës.<sup>117</sup> Sipas Barletit ajo ndodhej diku në afërsi të kodrës së Pashës,<sup>118</sup> mbase në lindje të saj, jo shumë larg kishës së Shna Prendës<sup>119</sup>, megjithatë vendndodhja e saj e saktë nuk mund të përcaktohet me saktësi.

Sipër saj, mu në mes të kodrës së Pashës, osmanët gjatë Rrethimit të Dytë të Shkodrës vendosën një top që mund të gjuante gjyle me një peshë prej njëmijë e treqind librash.<sup>120</sup> Kishën e përmend në vitin 1950 Gj. Sheldija, gjatë punës së komisionit të Muzeut të Shkodrës, ku kishte qenë i pranishëm edhe Atë Marin Sirdani. Ata kishin vënë re “*absidin e një kisha të madhe ... dhe rrasa të mëdha mermeri të bardhë me gdhendje lulesh, punë artistike e një dore mjeshtrërore*”<sup>121</sup>. Këto mund të viheshin re vetëm, kur uji i Kirit (Drinasës) shterronte dhe përveç tyre shiheshin edhe pjesë muresh cikloprike që i përkisnin ledheve rrethuese të qytetit të vjetër.<sup>122</sup>

Një gjurmë tjetër kishtarë<sup>123</sup> supozohet edhe tek *Tyrbja e Baba Atës*<sup>124</sup> dhe tek medreseja që ndodheshin në lagjen e vjetër Qafë, e cila ndodhej menjëherë pasi kalohej ura e qafës në krah të majtë, aty ku fillon rruga me kalldrëm. Kjo medrese është shumë e vjetër dhe pretendohet se është ndërtuar nga Mehmet Pashë Bushatlliu rreth viteve 1760-1770, dhe se ishte institucioni i parë arsimor dhe kulturor islam në Shkodër.<sup>125</sup> Në lidhje me të, W. Kamsi shton se “*tue pa, kur ende s’i kishte humbë tiparet e veta, vendosjen e muret mesjetare që e rrethojshin, ishte e kjartë e pa shumë vështirësi mund të mendohej si një ndër objektet që përbajshin Shkodrën e krishterë mesjetare. Pra mund të ketë qenë njeni*

<sup>115</sup> *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve (1416-1417) ...*, f. 26 (fl. 6a).

<sup>116</sup> Th. A. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische ...*, f. 24.

<sup>117</sup> K. Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen ...”, f. 262.

<sup>118</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës...*, f. 60

<sup>119</sup> Shënim i David Hosaflook në: Marin Barleti, *The Siege of Shkodra*, translated & edited by David Hosaflook, Tiranë: Onufri 2013, f. 84, ref. 33; f. 99, ref. 73.

<sup>120</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës...*, f. 60.

<sup>121</sup> *AIH*, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 11.

<sup>122</sup> Po aty.

<sup>123</sup> W. Kamsi, “Kisha e Kuvende të Shkodrës ...”, f. 124.

<sup>124</sup> H. Bushati, *Shkodra dhe motet ...*, vëll. I. f. 66.

<sup>125</sup> S. Bala & B. Alushi, *Institucionet islame të Shkodrës ...*, f. 24.

*ndër kuvendet a monastiret në qytetin e Shkodrës.*<sup>126</sup> Nga këto sot nuk ka mbetur as edhe një shenjë. Në një foto të vjetër të bërë në gjysmën e parë të shek. XX, krahas së medresesë përmendur vihen re fare qartë edhe mbetjet e disa mureve mesjetare, për të cilat mendojmë se i përkasin këtij monumenti anonim kishtar.

***Kisha e shën Kollit në Luguçezme.*** Kjo kishë ka qenë në lagjen e vjetër Luguçezme menjëherë sa kalohet “Ura e Kërçiles”. Megjithëse nga ndonjë autor mysliman ajo mbahet si xhami e ndërtuar në vitin 1801<sup>127</sup>, kjo kishë duhet të jetë transformuar në xhami që në shekujt e hershëm të pushtimit osman, por nuk e humbi emrin dhe u quajt “Xhamia e Shën Kollit”<sup>128</sup>, e njohur ndryshe edhe si *Xhamia e Haxhi Bajramit*.<sup>129</sup> Ajo filloi të mos riparohej e të mos përdorej më që në fillim të viteve 1950<sup>130</sup>, duke pësuar fundin me zgjerimin dhe asfaltimin e rrugës së Perashit<sup>131</sup>, e pastaj edhe pasojat e “Revolucionit Kulturor” të importuar nga Kina duhet të kenë bërë punën e vet përfundimtare. Kështu që rrënojat e kësaj kishë-xhamie nuk mund të shihen më, sepse kjo zonë është mbuluar plotësisht me ndërtime të reja, dhe në vitet e fundit, me ndërtimet e Unazës së Madhe të Shkodrës iu dha goditja përfundimtare edhe mbetjeve të “Urës Kërçile”, të cilat u mbuluan me beton e asfalt.\* Ura Gërçile do të kishte qenë edhe sot pikë referimi për lokalizimin e kësaj kisha. Nga reliket e saj ka mbetur vetëm një ujëbekore që ruhet edhe sot në Muzeun e Shkodrës.<sup>132</sup> Ndërsa në kohën kur xhamia që në këmbë, por që përdorej më vonë si depo karburanti, në brendësi të saj ishin venë re disa afreske dhe figura shenjtoreësh, dhe kur kjo gjë u vu në dukje, sipas W. Kamsit “*u kërkue të baheshin hetime, gërmime e studime në vend, erdh urdhri për shembjen e saj*”<sup>133</sup>.

<sup>126</sup> W. Kamsi, “Kisha e Kuvende të Shkodrës ...”, f. 124.

<sup>127</sup> Sipas S. Balës dhe B. Alushit, “*Xhamia është ndërtuar në vitin 1801, nga Haxhi Muhamet Begu, në tokën vakëf, përbri varrezave. Xhamia ka qenë 8 x 16 x 4 m me minare dërrase*”. S. Bala & B. Alushi, *Institucionet islame të Shkodrës ...*, f. 77.

<sup>128</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve...*, f. 110.

<sup>129</sup> W. Kamsi, “Kisha e kuvende të Shkodrës ...”, f. 128.

<sup>130</sup> S. Bala/B. Alushi, *Institucionet islame të Shkodrës ...*, f. 77.

<sup>131</sup> W. Kamsi, “Kisha e kuvende të Shkodrës ...”, f. 128

\* Nga dëshmia e vetë autorit të këtij artikulli.

<sup>132</sup> Gj. Sheldija, *Kryepeshkvia Metropolitanë e Shkodrës ...*, f. 62.

<sup>133</sup> W. Kamsi, “Kisha e kuvende të Shkodrës ...”, f. 128.



Fig. 3. Pamje nga kishë-xhamia e Shën Kollit në Lukuçezme, me Urën Gërçile në afërsi të saj. Kartolinë e vjetër (marrë nga [www.delcampe.net](http://www.delcampe.net))

### Kisha në afërsi të qytetit dhe përtej Bunës

Një grup tjetër kishash ekzistonte edhe pak më larg nga kështjella. Këtu kemi përfshirë ato kisha që i takonin në atë kohë periferisë së qytetit dhe zonës përtej Bunës.

**Kisha e Shën Kollit përtej Bunës.** Kjo kishë duhet të ketë qenë përtej Bunës (menjëherë pas urës së vjetër të Bunës), sipas Gj. Sheldisë, në drejtim të Shirokës, pak pa mbërritë në Kazenë.<sup>134</sup> Për të mos shkaktuar konfuzion, duhet të sqarohet këtu që kishte dy lokalitete me emrin Kazenë: njëri ishte fshati Kazena përtej Bunës, rrugës për në Shirokë, kurse lokaliteti tjetër është i dokumentuar si “Kazenë përballë portës kryesore të qytetit të Shkodrës”<sup>135</sup> mbi Malin e Shkodrës. Rrënojat e kësaj Kisha kanë ekzistuar deri në fillim të gjysmës së shek. XX. Nga populli thirrej “Kisha e Shën Kollit” dhe që ishte djegur në vitin 1918, kur ushtria austro-hungareze po tërhiqej nga territori shqiptar.<sup>136</sup>

<sup>134</sup> AIH, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 11.

<sup>135</sup> Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve (1416-1417) ..., f. 26 (fl. 6ab).

<sup>136</sup> AIH, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 11.

Mesa duket, kjo kishë në origjinën e saj kishte qenë katolike, sepse qe themeluar në vitin 1288 nga Helena Anzhu<sup>137</sup>, e veja e mbretit serb Uroshit I,<sup>138</sup> e cila ishte katolike dhe franceze dhe njihet tashmë si mbështetëse katolicizmit dhe e ndërtimit të kishave katolike, jo vetëm në Shkodrën dhe në krahinat përreth saj në veçanti, por edhe në të gjithë



Fig. 4. Pamje nga rrënojat e Kishës së Shën Kollit përtej Bunës. Fototeka Marubi

Mbretërinë Serbe në përgjithësi. Përreth saj në aty nga mesi i shek. XX, shiheshin varre ortodokse, por përveç këtyre kishte edhe disa varre të tjera, mbase katolike, për të cilat thuhej si ishin varret e ipeshkvinjve të Shkodrës.

Në kishë ortodokse ajo duhet të jetë shndërruar në periudhën osmane, ngaqë iu dhurua komunitetit ortodoks nga një vezir i Shkodrës, si shpërblim për punën që pati bërë ky komunitet për përforcimin e ledheve të kalasë.<sup>139</sup> Kjo kishë sipas Willi Kamsit mund të ketë qenë edhe Kisha e Shën Mërisë Magdalenë për të cilën do të flasim më poshtë. Sipas Kamsit Kisha e Shën Mërisë Magdalenë, që në origjinën e saj ishte katolike, iu mor katolikëve nga Selim Pasha i Shkodrës, i cili ua dha atë ortodoksëve në vitin 1745.<sup>140</sup>

Në lidhje me këtë Kamsi i referohet një dokumenti të botuar nga Atë Zef Valentini, ku thuhet se “*pak mâ andej kahë veri, gjindet një kishëz tjetër qi thirret: e Shën Kollit, po edhe kjo në breg të Buenës. Kjo (kishëz) është e mbëlueme (me pullaz), e per brenda muret, (janë) krejtë të zburkuese me piktura, qi paraqesin shum mrekulli të Shën Nëkollit e tjerë shëjten të vizatun. Por ket kishë, tesh mâ se tridhjet vjet, tuj pase ndertue Selim Pasha i Shkodrës disá saraje, tuj u a hjekun Katholikvet, e lëshoj në dorë të Grekvet e të Skizmatikvet Slav, si mba lypjes e lutjes së*

<sup>137</sup> Po aty.

<sup>138</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 107.

<sup>139</sup> AIH, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 11.

<sup>140</sup> W. Kamsi, “Kisha e kuvende të Shkodrës ...”, f. 128

*krye-muratarit, qi ishte grek, e që prej kësajë kohe, prej pakujdesit të Ktholikhvet, (Skizmatikët e kanë të veten*”<sup>141</sup>. Megjithatë të dhënat e mësipërme nuk japin dëshmi të mjaftueshme rreth shndërrimit të kishës katolike të Shën Nikollit në kishë ortodokse të Shën Maria Magdalenës dhe si rrjedhim nuk e hedhin poshtë ekzistencën e të dy kishave në afërsi të njëra tjetrës. Për këtë arsye kishën e Shën Mari Magdalenës po e trajtojmë veçmas si më poshtë.

***Kisha e Shën Maria Magdalenës.*** Përveç manastirit të Shën Pjetrit, ortodoksët në Mesjetë kishin edhe një tjetër, e cila ishte “Kisha e Shën Mëria Magdalenës”. Kishën e përmend edhe Marin Barleti në veprën e tij “Mbi rrethimin e Shkodrës”. Sipas Barletit, tek kjo kishë u ekzekutuan nga turqit (duke i ngulur në hunj) tetë burra, të cilët kishin sulmuar vazhdimisht shatorret e armikut dhe ishin kapur rob brenda një anije, gjatë një luftimi që po zhvillohej mbi Bunë ndërmjet tyre dhe turqve.<sup>142</sup> Kjo kishë, edhe pse ortodokse, që ishte praktikisht jashtë qytetit të Shkodrës, duhet të jetë përdorur dhe nga katolikët gjatë periudhës së vështirë osmane dhe aty duhet të kërkohet dhe varreza katolike e kësaj periudhe (varreza diku në afërsi të lagjes së romëve).<sup>143</sup> Kjo ishte kisha e vetme e krishterë funksionale që kishte mbetur në Shkodër<sup>144</sup>.

***Kisha e Shën Mërisë përtej Bunës.*** Kjo kishë e vjetër ka ekzistuar përtej Bunës (menjëherë pas urës së vjetër të Bunës), sipas Gj. Sheldisë, në drejtim të Shirokës, pak pa mbërritë në Kazenë, menjëherë pas rrënojave të “Kishës ortodokse të Shën Kollit”.<sup>145</sup> Në vitin 1610 kjo kishë i përkiste famullisë së Shkodrës dhe aty gjendej edhe varri i Albertinit, njërit prej ipeshkëve të Shkodrës, mbi të cilin kishte një rrasë mermeri me mbishkrim përsipër.<sup>146</sup> Rrënojat e kësaj kishë nuk mund të gjenden më.

<sup>141</sup> Zef Valentini, “Përfundimet historike të një dokumenti”, në: *LEKA*, IV/1934, nr. 8, f. 261; Zef Valentini, “Prej dokumentave të Farlatit”, në *LEKA*, IV/1932, nr. 12, f. 377; shih edhe: W. Kamsi, “Kisha e kuvende të Shkodrës ...”, f. 128

<sup>142</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës...*, f. 64.

<sup>143</sup> Th. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische ...*, f. 39; shih edhe: W. Kamsi, “Kisha e kuvende të Shkodrës ...”, f. 127.

<sup>144</sup> Th. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische ...*, f. 39.

<sup>145</sup> *AIH*, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 12.

<sup>146</sup> Po aty.

***Kuvendi i Shën Françeskut dhe i Shna Ndout përtej Bunës.*** Ky kuvend gjendej diku rrugës për në Shirokë dhe duhet t'i përkasë periudhës mesjetare. Ai u dogj nga trupat austro-hungareze në vitin 1918, gjatë tërheqjes së tyre.<sup>147</sup> Ndërsa L. Shllaku, është i mendimit që ky kuvend, i braktisur që në shekujt e parë të pushtimit osman dhe i plotë deri në shek. XIX, duhet të jetë dëmtuar rëndë nga tërmeti i madh në gjysmën dhjetëvjeçarit të shtatë të shek. XIX.<sup>148</sup> H. Bushati njofton për një riparim të kësaj kishe në vitin 1835 nga familja Curani, dhe në lidhje me këtë, sipas tij, kjo familje ka (pasë) një dokument të shkruar në turqisht, në të cilin nga kadiu e valiu i atëhershëm i Shkodrës i jepet leja Mark Curanit, stërgjyshit të Curanëve, për të meremetuar kishën në fjalë, dhe kjo leje sipas H. Bushatit i qe dhënë atij në vitin 1254 të hixhrit (1835).<sup>149</sup>

Sipas Gj. Sheldisë, aty kishte bërë gjermime edhe Franc Nopça, i cili paska gjetur në rrënojat e tij dokumente dhe pasuri të tjera.<sup>150</sup> Po sipas Gj. Sheldisë, ky kuvend paska pasë edhe një kalim të nëndheshëm që e lidhte atë me Bunën.<sup>151</sup> L. Shllaku shkruan se aty afër saj ekzistonte edhe një hospic\* françeskan që funksiononte edhe si strehë bujtinore, porse gjermadhat e tyre nuk mund të evidentohen pasi topografia aty është përmbysur plotësisht.<sup>152</sup> Nga mbetjet e këtij kompleksi sot nuk mund të vërehet as edhe një shenjë.

***Faltorja anonime mbi Sukën e Sh' lavrelit*** (Ishulli Para ish Fabrikës së çimentos), ose e quajtur ndryshe Suka e Shën Levrednit. Ajo ndodhej në fshatin mesjetar Kazenë, e cila në shek. XVIII, llogaritej tashmë në lagjet e qytetit.<sup>153</sup> Mbi këtë sukë gjatë punimeve arkeologjike të vitit 1950, të kryera nga komisioni i Muzeut në bashkëpunim me të

<sup>147</sup> Po aty.

<sup>148</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve ...*, f. 77.

<sup>149</sup> H. Bushati, *Shkodra dhe motet ...*, f. 611.

<sup>150</sup> *AIH*, G-I-24, Monumentet historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 12.

<sup>151</sup> Po aty.

\* *Hospic* (lat. *hospitium*) ka qenë dhe është një ndërtesë, pjesë e një manastiri apo në përkatësi të një urdhri fetar (fraskanët, por jo vetëm, kanë një traditë të admirueshme në këtë drejtim), ku kanë gjetur strehim dhe përkujdesje njerëz në nevojë dhe të sëmurë. Sot *hospicet* shërbejnë më tepër për njerëz të cilët janë të sëmurë në mënyrë të pashërueshme dhe të cilëve u jepet përcjellja e fundit.

<sup>152</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve ...*, f. 75.

<sup>153</sup> Gj. Sheldija, *Kryepeshkvia Metropolitane e Shkodrës ...*, f. 79.

deleguarin e Institutit të Shkencave Hasan Ceka, u gjetën gjurmët e një faltoreje me afreske me vlerë të madhe.

Rreth saj kishte pasur edhe varre dhe aty, në vitin 1950, ishte gjetur edhe një objekt floriri që i përkiste epokës së Kostandinianit II (375-392).<sup>154</sup> Përveç këtyre ishin gjetur edhe monedha të periudhës së perandorit Justinian (shek. VI), të cilat u morën në dorëzim nga punonjësit e muzeut.<sup>155</sup>

Në lidhje me një kishë tjetër mesjetare dedikuar Shën Lorencit na flet edhe H. Bushati, i cili përmend një kishë të tillë mbi të cilën u ndërtua xhamia e lagjes Alibegaj, e cila ndodhej diku përballë Kishës së Zojës.<sup>156</sup> Të dhëna të tjera mbi këtë kishë nuk kemi.

***Kisha e Shna Prendës në Zusë.*** Kjo kishë ka qenë gjithashtu e vjetër dhe mesa duket i përket periudhës mesjetare. Ajo ndodhej në fshatin Zusë që u islamizua tërësisht. Megjithatë për këtë kishë, banorët e këtij fshati ruanin një respekt të veçantë dhe ajo ishte kthyer në një vend pelegrinazhi, i cili vizitohej nga qytetarët e Shkodrës për çdo vit, më 26 korrik.<sup>157</sup> Veziri i Shkodrës, Kara Mahmut Pashë Bushati (1747-1796) e restauroi këtë kishë të vjetër, pra këtu bëhet fjalë për restaurim nga ana e pashës dhe jo ndërtim të plotë.<sup>158</sup> Mesa duket këtu bëhet fjalë për Kishën e Shna Prendës që së bashku me Kishën e Shën Mërisë Magdalenë në vitin 1745 (sipas regestit të Imzot Pal Kamsit), i përkisnin lagjes Qafë, varret e së cilës ndodheshin në Zarufë afër Shirokës, aty ku janë sot varret e fshatit (Shirokë).<sup>159</sup> Muret e saj pa çati i rezistuan kohës deri në vitet 70, “revolucionin kulturor” i rrafshoi pastaj krejtësisht.<sup>160</sup> Sot nuk ka mbetur më asnjë gjurmë nga kjo kishë. Sipas Gj. Sheldijës, pranë kësaj kishe ka pasur edhe varre ipeshkvijsh.<sup>161</sup>

<sup>154</sup> AIH, G-I-24, Monumentat historikë të Veriut nga Gjush Sheldija ..., fl. 10

<sup>155</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve* ..., f. 85.

<sup>156</sup> H. Bushati, *Shkodra dhe motet* ..., f. 610.

<sup>157</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve* ..., f. 84.

<sup>158</sup> *Po aty.*

<sup>159</sup> Gj. Sheldija, *Kryeipeshkvia Metropolitane e Shkodrës* ..., f. 79.

<sup>160</sup> L. Shllaku, *Shtegtimi i monumenteve* ..., f. 84.

<sup>161</sup> Gj. Sheldija, *Kryeipeshkvia Metropolitane e Shkodrës* ..., f. 79.

### **Kisha të tjera të palokalizueshme dhe anonime**

Në lidhje me urdhrin françeskan, përveç kishave që përmendëm më sipër, ky urdher kishte edhe një kishë tjetër që është e dokumentuar si **“Kisha e Françeskanëve”** (1395). Me sa duket françeskanët në vitin 1391 patën probleme me priftërinjtë dioqezanë.<sup>162</sup> Mbi vendndodhjen e kësaj kisha tani për tani nuk mund të japim ndonjë mendim, pasi kjo kishë nuk përmendet pothuajse fare nëpër dokumentet dhe materialet që disponojmë.

Ndërsa Urdhri Dominikan kishte **“Kishë e Shën Elias në Manastirin e Dominikanëve”** (1444)<sup>163</sup>. Se, kur u vendosën ata për herë të parë në Shkodër, këtë sot për shkak të mungesës së burimeve nuk mund ta dimë, porse ata kishin pasur pozicione të rëndësishme herë pas here në ipeshkvinë e Shkodrës. Këtu mund të përmend për shembull Antonin (Antonius) ipeshkëv në Shkodër prej vitit 1367 dhe Emanuelin, ipeshkëv i kësaj dioqeze prej vitit 1451, që të dy këta klerikë i përkisnin Urdhrit Dominikan.<sup>164</sup> Urdhri Dominikan ishte i pranishëm në Shkodër deri me pushtimin osman në vitin 1479, dhe si përfaqësues të tyre gjatë rrethimit të dytë të Shkodrës, mund të përmendet kleriku shqiptar “fra Bartolomeu i Urdhrit të Predikuesve”<sup>165</sup> (d.m.th. i Dominikanëve).

**Kisha e Shën Teodorit.** Në Shkodrën mesjetare përmendet, se ka ekzistuar edhe “Kisha e Shën Teodorit” (Sankt Theodor), e cila, sipas Jireçekut, në vitin 1416 ishte rrënojë.<sup>166</sup> Mbi këtë kishë nuk qe e mundur të gjendet as edhe një e dhënë tjetër. Shufllaj është i mendimit që kjo kishë duhet të jetë ndodhur diku jashtë mureve të qytetit.<sup>167</sup> Përsa i përket kultit të Shën Todrit në zonat përreth Shkodrës kemi të dokumentuar edhe dy vende të tjera që lidhen me emrin e këtij shenjtori. Së pari Shën Todri në Mes-Myselim (në afërsi të Drishtit) dhe Shën Todri në bregun e djathtë të Bunës (në rrethin e Ulqinit).

<sup>162</sup> O. Schmitt, *Das venezianische Albanien ...*, f. 137.

<sup>163</sup> *Po aty*.

<sup>164</sup> D. Farlati, *Illyrici Sacri ...*, VII, f. 310, 313.

<sup>165</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës...*, f. 52.

<sup>166</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 107.

<sup>167</sup> M. Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen ...”, f. 262.

***Manastiri ortodoks i Shën Pjetrit.*** Në Shkodër serbët kishin një manastir, të ashtuquajturin “*Manastiri i Shën Pjetrit*”, i cili ishte nën juridiksionin e Metropolitit të Zetës, i cili u caktua (vendos si metropolit) në vitet 1404 dhe 1426 nga patriku i Sllavisë (patriku i përgjithshëm sllav - E.M.) (*patriarcha Sclavonie*).<sup>168</sup> Ky manastir ortodoks në Shkodër së bashku me *Manastirin e të shenjtit Kryeengjell Mihael* që gjendej nën kështjellën e Ulqini, që ishin të ngjashëm dhe në literaturë cilësohen si “binjakë”, qenë themeluar nga Gjergj Balsha II († 1403), dhe qenë të vendosur jo drejtpërdrejtë nën patrikun sllavon nga peshkopi i Zetës, me një igumen në krye.<sup>169</sup> Këto dy manastire ortodokse u përkasin atyre që filluan të duken madje edhe në qytetet romane të zonës bregdetare. Në vitin 1401 përmenden fshatarë tributarë të manastirit të Shën Pjetrit në Shkodër (*hominibus servientibus ecclesie s. Petri de Scutaro*) të cilëve Balshajt<sup>170</sup> u dhuruan një “vend peshkimi që nga kohët e vjetra” i cili ndodhej në Bunë (*unam pisceriam, in dicto flumine ...*)<sup>171</sup>.



Fig. 5. Rrënojat e një kisha të vjetër anonime në Shkodër në lumin Buna. Lit. e E. Schweinfurt. Marrë nga Albumi i Lloyd Austriaco, “Album di vedute pittoresche della Dalmazia e de’ paesi contermini.”

<sup>168</sup> K. Jireček, Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 107-108.

<sup>169</sup> M. Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen ...”, f. 236.

<sup>170</sup> Listine Sime, *Listine o odnosajih izmedju juznoga Slavenstva i mletacke republike / Skupio Sime Ljubic*, Knjiga 5; *Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium*, 5. Zagrebu: 1875, nr. 43 (1404), nr. 84 (1406) dhe 9, nr.16 (1426); Šufflay, “Kirchenzustände...”, f. 236.

<sup>171</sup> AAlb II, nr. 748.

Deri më sot vendndodhja e këtij manastiri akoma nuk është lokalizuar. Megjithatë në lidhje me vendndodhjen e tij, disa të dhëna na i jep Barleti. Ai në veprën “*Mbi rrethimin e Shkodrës*”, na përmend kishën ortodokse të Shën Pjetrit (pra jo manastir), e cila ndodhej mbi “Rrotë”, një vend ky që ndodhej diku “*jashta ledheve, andej nga lindja, krejt pranë qytetit, i pashteg e plot shkambij të thepisun*”<sup>172</sup>. Barleti më tej na tregon se, Rrota “*në majë ishte e rrafshhtë; aty ishte ndërtue një kishë kushtue Shën Pjetrit, ku grekët (d.m.th. ortodoksët – E.M.) luteshin dhe kryenin ceremonitë fetare*”<sup>173</sup>. Ky vend kishte një rëndësi të madhe strategjike për mbrojtjen e Shkodrës dhe si rrjedhim “*e kishin forcue me të gjitha llojet e fortifikimeve e të armëve e pra shërbente si mbrojtja ma e fuqishme ashtu si për kështjellën, ashtu edhe për një pjesë të madhe të qytetit*”<sup>174</sup>. Gjatë Rrethimit të Dytë të Shkodrës, “*pikërisht prej atij vendi, sipas Barletit, u ba mbi turqit kërdi e madhe dhe u shpartalluen fare*”<sup>175</sup>.

**Kisha katolike e Shën Pjetrit të Shkodrës.** Në Shkodër na del e dokumentuar edhe një kishë katolike e quajtur Shën Pjetri i Shkodrës.<sup>176</sup> Llazarit priftit të kësaj kisha, i cili ishte caktuar aty nga vetë Pontifeksi i Lartë (Papa), i vërtetohet nga Këshilli i Senatit venedikas edhe një herë beneficet të cilat i ishin caktuar më parë nga vetë ai (Papa). Ai kishte merita, sepse kishte dhënë kontribut në favor të sundimit venedikas në kohën e kryengritjeve që plasën në krahinën e Shkodrës kundër këtij sundimi. Dokumenti ku përmendet kjo kishë është lëshuar nga Senati venedikas dhe mban datën 15 maj 1406.<sup>177</sup>

**Kisha e Shën Barbaras.** Një dokument venedikas më datë 29 prill të vitit 1403 na bën të ditur edhe ekzistencën e një kisha të dedikuar Shën Barbaras, pra Kisha e Shën Barbaras së Shkodrës, e cila kishte marrë hua një Kambanë, sepse kambana e saj u ishte dhënë rojeve të kështjellës, ngaqë e tyrja ishte thyer.<sup>178</sup> Rreth vendndodhjes së saj nuk mund të themi

<sup>172</sup> M. Barleci. *Rrethimi i Shkodrës...*, f. 72.

<sup>173</sup> *Po aty.*

<sup>174</sup> *Po aty.*

<sup>175</sup> *Po aty.*

<sup>176</sup> *AIH*, A-III-563, “Dokumente për historinë e Shqipërisë së shek. XV (1406-1410)”, vëll. II, përgatitën për botim: Injac Zamputi, Përparime Huta (të pabotuara), nr. 21.

<sup>177</sup> *Po aty*, dok., nr. 48.

<sup>178</sup> *AIH*, A-III-562, “Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV”, vëll. I. (1400-1405), nr. 327, f. 394.

asgjë për momentin. Kjo kishë nuk na figuron akoma nëpër burime të tjera që disponojmë për momentin.

\* \* \*

Këto ishin pra disa të dhëna mbi kishat në qytetin mesjetar të Shkodrës.

### *S u m m a r y*

#### CHASING THE TRACES OF ECCLESIASTICAL MONUMENTS INSIDE OF MEDIEVAL SCUTARI

This article gives a concise overview about the ecclesiastical monuments of medieval Shkodra. Before the Ottoman conquest, the City of Shkodra (Skodra/Scutari) had many churches and chapels and the researchers qualified it as an important center of Albanian Catholic clergy in the Middle Age. The churches of Shkodra were thick-walled and so far we know this city had a large number of churches and monasteries. Besides the aforementioned churches, I have found traces of other anonymous churches, about which we don't know today what was their name. Among them there are others, which cannot be localized, where they were in the city.